

VENDIM
Nr.798, datë 22.7.2009

PËR LICENCIMIN E KOLEGJIT PROFESIONAL, PRIVAT, “NEW GENERATION”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 7, 43, 44 e 45 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Licencimin e kolegjit profesional, privat, “New Generation”, i cili do ta ushtrojë veprimtarinë në qytetin e Tiranës.

2. Kolegji profesional, privat, “New Generation”, do të ofrojë programin e studimit, të ciklit të parë, në formën e studimit me kohë të plotë, në “Masazheri estetiko-kuruese” i cili do të zgjasë 3 (tri) vite akademike.

Në mbarim të studimeve lëshohet diplomë e nivelit të parë (DNP) në “Masazheri estetiko-kuruese”.

3. Ngarkohet kolegji profesional, privat, “New Generation”, që, për programin e studimit, të sigurojnë, nëpërmjet marrëdhënieve kontraktuale, zhvillimin e disa prej disiplinave kryesore formuese të specialitetit, pas vitit të parë, nga një personel akademik i huaj, me kualifikimin e nevojshëm.

4. Kolegji profesional, privat, “New Generation”, ta fillojnë veprimtarinë mësimore për programet e studimit, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, pasi të kenë marrë, jo më vonë se tre javë para fillimit të vitit akademik, lejen përkatëse nga Ministri i Arsimit dhe Shkencës.

Ministri e lëshon lejen pasi vlerëson se institucioni privat i arsimit të lartë ka përmbushur angazhimet e deklaruara, në përputhje me udhëzimin e tij për këtë qëllim.

5. Ndryshimet në vendndodhje, plane, forma studimi dhe programe, si dhe në elemente të tjera, të miratuara, bëhen pas miratimit nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

6. Kolegji profesional, privat, “New Generation”, duhet t’i nënshtrohet procesit të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit, brenda afateve të përcaktuara në ligjin në fuqi.

7. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe Shkencës për kontrollin periodik të ligjshmërisë në institucion dhe për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha